



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Haxhijaha" Sh.P.K. të datës 31.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** si e **pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Haxhijaha" Sh.P.K. të datës 31.10.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.10.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** grupi i operatorëve ekonomik "Haxhijaha" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Haxhijaha" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 31.10.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 27.09.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit" me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore të parashtruesit janë cituar si në vijim:

- I. *“Ne FTD pika 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 4, citoj: OE duhet te dorezoj nje autorizim apo konfirmim I prodhuesit te superstruktures, Deshmit e kerkuara: Autorizimi qe permban sherbimet e dizajnit, zhvillimit, prodhimit, shitjes dhe sherbimi pas shitjes te automjeteve dhe pajisjeve komunale, **operatori i propozuar per kontrat ka paraqitur autorizimin nga prodhuesi ne te cilen e autorizon vetem per ofertim, negocim dhe dhenie te ofertes ndersa nuk e autorizon per sherbimet e dizajnit dhe sherbimi pas shitjes te automjeteve dhe pajisjeve komunale”**.*
- II. *“Ne FTD pika 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 5, citoj: OE duhet te dorezoj nje vertetim te karakteristikave teknike te kerkuara te superstruktures – Deshmi: Vertetim I firmosur dhe vulosur nga prodhuesi I superstruktures, me numer te prokurimit publik dhe modelit te superstruktures se ofruar - **operatori i propozuar per kontrat nuk ka e saktuar modelin e superstruktures me te cilen oferton”**.*
- III. *“Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 8, citoj: OE duhet te dorezoj nje certifikat te vlefshme per testimin e kualifikimit te saldatorve sipas standardit EN ISO 9606-1 2017 ose standardit kombtar ekuivalent, per te pakten 5 saldator te punesuar nga prodhuesit e superstrukturave me deshmi punesimi – ne qasje ne dokumentat te kerkuar ne AK si dhe ofrimin te tyre verejm se **operatori i propozuar per kontrat ka ofruar certifikatat e kualifikimit te saldatorve sipas standardit te kerkuar por asnjeri nga ata nuk e ka certifikaten e vlefshme, pra jan me validitet te skaduar”**.*
- IV. *“Ne FTD ne piken 9.1&9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 13, citoj: OE duhet te dorezoj katalogun e shasis, deshmi: Katalogu I nenshkruar dhe vulosur; Per shasin e ofertuar te brendit ATLAS Ne website zyrtare te kompanis per te cilen **operatori i propozuar per kontrat ka autorizim per ofertim per kete tenderi, modeli i ofertuar eshte me specifikat te ndryshme nga ato qe jane bashkangjitur ne DT”**.*
- V. *“Ne FTD ne piken 9.1& 9.2 perkatesisht tek kerkesat mbi mundesit teknike dhe/ose profesionale, pika 13, citoj: OE duhet te dorezoj katalogun e shasis, deshmi: Katalogu I nenshkruar dhe vulosur; Per shasin e ofertuar te brendit FORD Ne website zyrtare te kompanis, **modeli ofertuar nga ky operator ekonomik i propozuar per kontrat eshte me specifikat te ndryshme nga ato te bashkangjitur ne dosjen e ketij tenderi”**.*
- VI. *“Ne autorizimin e paraqitur nga operatori i propozuar per kontrat te prodhuesi FORD, shihet qe kompania prodhues FORD CEE Sales LLC e autorizon kompanin ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. me seli ne Tirane ne Republiken e Shqiperis per shitjen e makineris, pjeseve rezervo dhe aksesorve ne territorin e Shqiperis, me sakt: kompania ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. eshte importues/distributor zyrtar per territorin e Shqiperis, dmth company ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. eshte e autorizuar vetem per Republiken e Shqiperis e jo edhe per Kosove, **kompania ne fjale nuk e ka te drejten e shitjes, servisimit te kompanis FORD edhe per territorin e Republikes se Kosoves. Andaj autorizimi i ofruar nga ALBANIAN MOTOR COMPANY SH.P.K. i operatorit te propozuar per kontate eshte i pavleshem”**.*

Sa i përket pretendimit të parë (I) ankimor duhet sqaruar se as për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar autorizimin në emër të kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit. Kontestuese për parashtruesin është nëse ky autorizim duhet pranuar sipas dosjes së tenderit. Në këtë rast duhet cekur se komisioni vlerësues e ka pranuar këtë autorizim si dëshmi dokumentare të pranueshme për këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Nga analizimi i autorizimit për të cilën po bëhet fjalë, është gjetur se autorizimi i referohet aktivitetit përkatës të prokurimit dhe është lëshuar nga prodhuesi i superstrukturës. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit të dytë (II) ankimor duhet sqaruar se as për parashtruesin nuk është fare kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar vërtetimin e firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës. Kontestuese për parashtruesin është nëse ky vërtetim është në përputhje me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit. Nga analizimi i autorizimit për të cilën po bëhet fjalë është gjetur se vërtetimi është firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës në përputhje të plotë me kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit.

Sa i përket pretendimit të tretë (III) ankimor duhet cekur se përmes kërkesës nr. 8 në kuadër të kapacitetit teknik dhe profesional sipas dosjes së tenderit është kërkuar “Kopja e certifikatës për testimin e saldatorëve sipas EN ISO 9606-1 2017. Nga dosja me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se janë dorëzuar këto certifikata ISO në përputhje të plotë me dosjen e tenderit. Përmes sqarimeve të dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar me datë 21.10.2023 është konfirmuar se tenderuesi i rekomanduar i posedon certifikatat EN ISO 9606-1 2017 me afat të vlefshëm deri në vitin 2025. Prandaj edhe ky pretendim është i pabazuar në tërësi.

Sa i përket pretendimit të katërt (IV) dhe të pestë (V) ankimor janë analizuar katalogjet me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar. Në këtë mënyrë (por duke u referuar edhe te raporti i komisionit vlerësues) nuk është gjetur se ekziston mospërputhje ndërmjet të katalogjeve të ofertuara dhe specifikave në përputhje me dosjen e tenderit. Prandaj edhe këto dy pretendime janë të pabazuara në tërësi.

Sa i përket pretendimit të gjashtë (VI) ankimor nga raporti i komisionit vlerësues por edhe nga dosja me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është gjetur se nuk qëndron pretendimi distributori për të cilin po bëhet fjalë që sipas parashtruesit nuk posedon autorizim për shitjen e pajisjeve në shtetin e Kosovës. Parashtruesi nuk e ka provuar me asnjë provë ose argument sipas të cilit autorizimi do të ishte i kufizuar. Pra nuk qëndron pretendimi i gjashtë (VI) ankimor pasi që autorizimi në fjalë në asnjë formë nuk është i kufizuar për shtetin e Kosovës.

Sidoqoftë, nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij dhe nuk ka paraqitur fare argumente ose prova për të mbështetur kërkesën e tij për rishqyrtim. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 06.11.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.